



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A

**DEPARTAMENTI LIGJOR DHE PROKURIMEVE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE  
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT <sup>1</sup>**

**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

**Drejtuar:** Naim 2020 sh.p.k

**Adresa:** Tirane Farke SAUK Pranë Restorant "OSMA"

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur-Shërbim

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-59946-02-22-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Pastrim i Liqenit Bovillë me mjete teknologjike" 31.852.369,33 (Tridhjetë e një milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë presje tridhjetë e tre) lekë pa t.v.sh.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. "Naim 2020" sh.p.k**

M02417012V

31.683.204 (Tridhjetë e një million e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e katër) lekë pa TVSH.

**2. "Viola Green" sh.p.k**

L51928004K

31.800.000 (Tridhjetë e një million e tetëqind mijë) lekë pa t.v.sh.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

**1. Oferta e paraqitur nga "Viola Green" sh.p.k, me vlerë të ofertës 31.800.000 (Tridhjetë e një million e tetëqind mijë) lekë pa t.v.sh.**

Per arsyet si më poshtë:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se dokumentacioni i paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Dokumentat Standarte të tenderit si dhe Kërkesat e vecanta për këtë procedurë prokurimi.

*Së pari:* Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit në seksionin 3.1 ka kërkuar sigurimin e ofertës në vlerën **637.047,386** (Gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e dyzet e shtatë presje treqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa t.v.sh.

Operatori ekonomik "Viola Green" sh.p.k nuk ka ngarkuar në SPE Sigurimin e Ofertës në përmbushje të pikës 1 të nenit 83 të LPP 162/2020 ku shprehimisht thuhet se : "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël"

Operatori ekonomik "Viola Green" sh.p.k nuk ka ngarkuar në SPE Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit në përmbushje të LPP neni 82 ku shprehimisht thuhet se : "*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*".

Përsa më sipër, operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim dhe për këtë arsye skualifikohet.

Operatori ekonomik nuk ka përmbushur kriterin 2.3.1 të kapacitetit Teknik lidhur me shërbime të ngjashme duke mos përmbushur kërkesën e përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe në nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Operatori ekonomik nuk ka përmbushur kriterin 2.3.2 të kapacitetit Teknik lidhur me liçencën e shoqërisë duke mos përmbushur kërkesën e përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe në nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Operatori ekonomik nuk ka përmbushur kriterin 2.3.8 të kapacitetit Teknik lidhur me çertifikatat ISO duke mos përmbushur kërkesën e përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përsa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 92 pika 3 *Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Naim 2020 sh.p.k me adresë Tirane Farke SAUK Pranë Restorant “OSMA”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 31.683.204 (Tridhjetë e një million e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e katër) lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [ ] është identifikuar si fitues i procedurës së prokurimit.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë Rruga Kavajes Nr.133, Njesia administrative Nr.6, Kodi Postar 1027 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do procedohet siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Elton KACIDHJA**